



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.06. 2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Myslim Murrizi, Antoneta Dhima, Edmond Rrushi, Elena Xhina, Luan Harusha, Elona Hoxha, Lefter Maliqi, Xhemal Qefalia, Alban Zeneli dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Arben Elezi, Ylli Shehu, Anduel Xhindi, Eljo Hysko

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Paulin Luli - Drejtor i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit

Artan Shkreli- Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Lilika Radovicka - Përgjegjëse Sektori

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare.

Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme të komisionit kemi shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”.

Për projektligjin e parë kemi të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht zëvendësministrin e Mbrojtjes, zotin Petro Koçi dhe zotin Paulin Luli, drejtor i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit.

Faleminderit për prezencën zotërinj!

Relatore e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare për këtë projektligj është zonja Dhima.

Ju lutem, zoti Koçi, bëni një prezantim të ndryshimit që ju kërkoni të bëni në këtë ligj.

Petro Koçi – Faleminderit!

Në përputhje me ligjin janë tri kategori mallrash që lëvrohen nga rezervat e shtetit sipas nevojave dhe situatave që krijohen.

Besoj se me këtë propozim ligji bëhet më koherent. Praktikisht, me ligjin aktual mallrat e “kategorisë a” lëvrohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ato të kategorisë “b” me urdhër të ministrit, të kategorisë “c” me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të rezervave. Duke bërë propozimin që mallrat e kategorisë “a” të lëvrohen me vendim të Kryeministrit, e bëjmë më koherent dhe më me kuptim të gjithë hierarkinë e vendimmarrjes. Gjithashtu, kjo bëhet për ta bërë më të zhdërvjelltë reagimin ndaj situatave emergjente. Është pa kuptim që për të zhvendosur një mjet të tonazhit të rëndë duhet të marrë vendim Këshilli i Ministrave.

Kështu që, për ta bërë më praktik dhe ekzekutiv reagimin në raste të tilla, propozojmë që mallrat e kategorisë “a” të lëvrohen me vendim të Kryeministrit pas propozimit të ministrit përkatës, në këtë rast ministrit të Mbrojtjes.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër për prezantimin!

Ndryshimi i propozuar në këtë projektligj ka për qëllim të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë shteti të kategorisë “a”, duke e zëvendësuar miratimin e lëvrimit të tyre me vendim të Këshillit të Ministrave me një akt individual, “Urdhër i Kryeministrit”, pasi krijon hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Ndryshimi i propozuar në këtë projektligj ka për qëllim të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë shteti të kategorisë “a”.

Ligji aktual përcakton se lëvrimi i mallrave rezervë të kategorisë “a” bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, lëvrimi i mallrave rezervë të kategorisë “b” bëhet me urdhër të ministrit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit, mallrat rezervë të kategorisë “c” lëvrohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.

Lëvrimi i mallrave të kategorisë “b” dhe “c” bëhet me anë të një akti individual, “urdhër i ministrit” dhe “urdhër i drejtorit të Përgjithshëm”. Kjo mënyrë e bën më të lehtë dhe më të shpejtë lëvrimin e mallrave të grupeve përkatëse, sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara ligjërisht.

Për shkak se miratimi i lëvrimit të mallrave të kategorisë “a” bëhet nëpërmjet një akti kolegjial, si ai i vendimit të Këshillit të Ministrave, kjo sjell vonesa në daljen e aktit të miratimit dhe deri në lëvrimin përfundimtar e tyre.

Gjithashtu, ndryshimi i propozuar ka për qëllim unifikimin e procedurës së lëvrimit të mallrave rezervë shteti të secilit grup, nëpërmjet një akti individual hierarkik, duke filluar nga drejtori i Përgjithshëm, ministri dhe Kryeministri.

Nisur nga këto argumente, unë mendoj që ne si deputetë duhet ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Nuk kam pyetje, por për qartësi dhe teknikë legislative do të sugjeroja që në fund të fjalisë “me propozim të ministrit”, të vendosej edhe termi “përgjegjës”.

Petro Koçi - Besoj se është në kontekstin e ligjit.

Edhe mund të vihet, por besoj se e nënkupton ligji se për çfarë ministri bëhet fjalë.

Ermonela Felaj – A ka ndonjë pyetje tjetër? Jo.

Atëherë, kalojmë te miratimi në parim i ndryshimit të propozuar në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”.

Kush është dakord me ndryshimin e propozuar?

Faleminderit!

Kalojmë te miratimi neni për nen.

Kush është dakord me nenin 1 të projektit? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2 të projektit? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të ndryshimit të propozuar në ligjin “Për rezervat materiale të shtetit? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Ky projekt votohet.

Shumë faleminderit, zoti Koçi dhe zoti Luli, për prezencën tuaj!

(Diskutime pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.06.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Edmond Rrushi, Elena Xhina, Luan Harusha, Elona Hoxha, Lefter Maliqi, Xhemal Qefalia, Alban Zeneli dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Arben Elezi, Ylli Shehu, Anduel Xhindi dhe Eljo Hysko.

Të ftuar:

Artan Shkreli- Zëvendesministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Lilika Radovicka - Përgjegjëse sektori

Ermonela Felaj - Kalojmë te shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”

Për prezantimin e këtij projekti nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi të ftuar zotin Artan Shkreli, zëvendësministër.

Zoti Shkreli, faleminderit për ardhjen në komisionin tonë!

Nuk e di nëse është i pranishëm zoti Krislen Keri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi të ftuar zonjën Lilika Radovicka, përgjegjëse sektori dhe zonjën Ada Shkurtaj, që është përfaqësuese e...

Është e pranishme zonja Shkurtaj? Dakord, vijojmë vetëm me përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Relatori i këtij projekti është zoti Vorpsi.

Fjala është për ju, zoti Shkreli, për të na bërë një prezantim të projektit. Ju lutem, fokusohuni tek ajo që na intereson më shumë neve, në pikëpamjen e sigurisë!

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Shkreli - Ju falënderoj!

Këtu flitet për një projektligj, që është rutinë, pra nuk ka asgjë të veçantë, përveç faktit që me Arabinë Saudite është hera e parë që krijojmë një marrëveshje dypalëshe. Marrëveshje të tilla ekzistojnë me të gjitha vendet e tjera, qoftë të rajonit ku ndodhet Arabia Saudite, qoftë edhe me vendet e rajonit tonë, të cilat të gjitha, pa përjashtim, kanë marrëveshje të tilla me Arabinë Saudite. Kjo marrëveshje është e së njëjtës natyrë, është një marrëveshje kuadër edhe me vendet e tjera të Bashkimit Europian. Zbatimi i marrëveshjes nuk ka efekte financiare. Marrëveshja përcakton kryesisht, për herë të parë me këtë vend, rregullat për transportin e ndërsjellë ajror. Flitet edhe për marrëdhënie midis aviacionit civil të të dyja vendeve. Marrëveshja nuk parashikon në asnjë pikë të saj gjëra që kanë karakter ushtarak apo natyrë sekrete.

Nga ana tjetër, përveç marrëdhënieve dhe flotave të ndërsjella, që i hapin rrugë vendosjes së një linje direkte mes Shqipërisë dhe Arabisë Saudite, marrëveshje parashikon edhe kalimet transite në hapësirat ajrore të këtyre dy vendeve, gjithmonë për qëllime të aviacionit civil.

Kuptohet, marrëveshja i ka të gjitha pikat që kanë të bëjnë me sigurinë, por, sikurse e thashë edhe më lart, këto janë në të njëjtin kuadër dhe nivel me marrëveshjet e vendeve të tjera.

Do të doja të referoja këtu edhe kundërshtimin e zonjës Hajdari në mbledhjen e Komsionit për Politikën e Jashtme, e cila ka votuar kundër, sepse thoshte se Arabia Saudite është një vend terrorist. Ky vend nuk bën pjesë në listat e zeza, as të Bashkimit Europian, as të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe, me sa dimë, nuk ka asnjë indikacion nga Ministria e Jashtme ndaj nesh, në ministrinë tonë ose në Drejtorinë e Aviacionit Civil, ku Arabia Saudite të ketë kaucioni të kësaj natyre.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shkreli!

Kjo nuk do të ndikojë në opinionin e këtij komisioni, sepse nuk ka lidhje me qëndrimin që mbahet këtu.

Zoti Vorpsi, urdhëroni!

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite “Për shërbimet ajrore” ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror.

Republika e Shqipërisë është nënshkruese e Aviacionit Civil Ndërkombëtar më 7 dhjetor të vitit 1947. Konventa e Chicagos ka detyrime të koordinojë veprimtarinë e saj në fushën e aviacionit civil. Bashkëpunimi në fushën e transportit ajror konsiston dhe orientohet nga parimi i krijimit dhe i komunikimit ndërmjet vendeve, çka justifikon edhe iniciativën e nisur për të realizuar këtë marrëveshje, e cila krijon hapësira dhe mundësi të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite “Për shërbimet ajrore” u përafrua në Tiranë më 25-26 shkurt të vitit 2014 në takimin midis përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Autoritetit të Aviacionit Civil dhe përfaqësuesve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Kjo marrëveshje, e nënshkruar nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Arabisë Saudite më 6 shkurt 2019, do të ndikojë në krijimin e kushteve të përshtatshme, të ndërsjella dhe lehtësuese për operatorët e transportit ajror të të dyja vendeve, si dhe për kalimin transit nëpërmjet territoreve të tyre, me qëllim lëvizjen pa pengesa për shtetasit e të dyja palëve.

I ftoj të gjithë kolegët deputetë ta miratojmë këtë marrëveshje!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Fjalën e ka zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të nderuar, që keni ardhur në Komisionin e Sigurisë!

Pyetja juaj ceku në atë që parashtruat para komisionit, që kjo është një marrëveshje kuadër. E njëjta marrëveshje që është në të gjitha vendet me të cilat ne operojmë. Kam një pyetje jashtë kontekstit të kësaj marrëveshjeje: a i lehtëson shpenzimet e qytetarëve shqiptarë kjo marrëveshje? Pra, përveçse është shumë mirë, lehtëson lëvizjen e mallrave dhe njerëzve në Arabi dhe kudo, por a e lehtëson barrën e shpenzimeve të shqiptarëve, apo është e njëjta histori, që shqiptarët do të vazhdojnë të paguajnë më shumë? Pa pjesën politike, absolutisht.

Artan Shkreli - Në komisione të tilla gjërat janë shumë konkrete. Këtu përmenden dy pika. I vetmi lehtësim që vjen nga kjo marrëveshje është linja direkte dhe kjo është pak a shumë një e dhënë e përgjithshme. Shpenzimet janë më të ulëta, sepse në vendet e ndërsjella projektligji parashikon në përgjithësi edhe procedura të lehtësimit fiskal kur janë të vendit, pra pa kaluar në vende të treta ose pa përdorur operatorët e tretë për këto fluturime.

Për sa i përket marrëveshjes në vetvete, në raport me marrëveshje të tjera nuk ka asnjë paragrafë ku të parashikohet një ulje e biletës apo e shpenzimeve të fluturimeve në raport me marrëveshjet e tjera paraardhëse. Ne shpresojmë shumë, këtu jemi jashtë politikës, në aktivizimin e aeroportit të Kukësit, nga njëra anë, sepse kjo marrëveshje nuk është ekskluzive vetëm e fluturimeve nga Aeroporti i Rinasit. Shpresojmë që me hapjen e tenderit ndërkombëtar që do të bëhet për aeroportin e Vlorës, sikurse e dini, është prishur ecuria e bisedimeve për aeroportin e Vlorës, përveç kushteve që do të jenë shumë të kontrolluara nga ana jonë për të mos u përsëritur situata e Aeroportit të Rinasit, që është një situatë koncesionare, vetë aeroportet do të hyjnë në konkurrencë me njëra-tjetrën. Në vetvete, për ta mbyllur këtë pjesë të pyetjes suaj, nuk parashikohet në raport me marrëveshje të tjera, që të kemi lehtësira specifike.

Alban Zeneli – Edhe dy pyetje. Duke marrë në konsideratë atë që tha zonja Hajdari në Komisionin e Jashtëm, pavarësisht opinioneve të secilit deputet, desha të di kjo marrëveshje a ka përcaktuar kërkesa më të larta për sa i përket të sigurisë për atë vend, apo siç janë marrëveshjet? Arabia Saudite nuk është vend terrorist, por vend që i shkel të drejtat e njeriut, pra ka ato probleme në vendin e vet.

A keni parashikuar ju në këtë marrëveshje disa elemente sigurie më të larta, apo jo?

Artan Shkreli – Marrëveshja në vetvete nuk parashikon elemente shtesë në raport me rregullat që përcakton Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil. Është kjo organizatë, e cila një mënyrë apo një tjetër, pavarësisht se është ndërkombëtare, i respekton shumë indikacionet nga vende që i ushtrojnë presion pozitiv kësaj, si Shtetet e Bashkuara dhe BE-së me vendet të cilat janë të organizuara në tri kategori. Janë vende ku nuk ka problematika të

fluturimeve apo të shkëmbimit të mallrave dhe njerëzve dhe janë të shënuara me një zonë portokalli, kurse me të kuqe vendet që kanë probleme me terrorizmin. Arabia Saudite, përtej pjesës politike, ku ka shumë shkelje të drejtave të të njeriut, hyn tek ato vende, të cilat nuk kanë pasur rekorde të mëparshme, që të ndikojë në mirëfunksionimin e marrëveshjeve të tilla me Aviacionin Civil. Nuk ka pasur raste me rrëmbim avionësh apo transportim lëndësh të paautorizuara apo probleme të tjera, por Arabia Saudite shënohet si vend problematik, pra me rrezik eventual për këtë gjë. Deri tani nuk ka pasur indikacion të kësaj natyre, kështu që nuk parashikohet në marrëveshje një pikë specifike për këtë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shkreli!

Lilika Radovicka – Dua thjesht ta përforcoj këtë. Për sa kohë jemi anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare e Aviacionit Civil jemi të detyruar që, në momentin që iniciojmë një marrëveshje, pa kaluar në procedurat ligjore, të shkëmbejmë nëpërmjet autoriteteve të aviacionit, idetë e inicimit të një marrëveshjeje. Në momentin që Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit ka një indice për rrezikshmëri, nuk të lë të vijosh me procedurat.

Artan Shkreli – Kini parasysh që ka një monitorim të dyfishtë që kur kemi hyrë në NATO, ne jemi të detyruar që të gjitha këto lloj marrëveshjesh t'i ratifikojmë dhe t'i depozitojmë për të qenë korrekt me ta.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Zonja Gjebrea, kishit edhe një pyetje, apo morët përgjigje më duket?

E morët përgjigjen.

Dakord.

Unë besoj se, nëse përgjigjet që u morën do t'i vihen në dispozicion zonjës, që sapo e përmendëm, ajo do të jetë më e qartë dhe do të ndryshojë opinion, sepse, të paktën u siguroam për atë pjesë që i intereson këtij komisioni.

Faleminderit!

Pyetje të tjera nuk ka, kështu që kalojmë në miratimin e marrëveshjes.

Kush është dakord me miratimin në parim marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”?

Kundër? Nuk ka?

Alban Zeneli – Edhe pse jam shumë dakord me marrëveshjen, por, për respekt të kryetares së grupit tim, do të abstenoj.

Ermonela Felaj – Atëherë 1 abstemin.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1?

Faleminderit!

Neni 2 parashikon që kjo marrëveshje hyn në fuqi në afatin e zakonshëm.

Kush është dakord me nenin 2?

Faleminderit!

Miratohet dhe nen për nen.

Faleminderit!

Kalojmë në miratimin në tërësi.

Kush është dakord me miratimin në tërësi marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”?

Kush është dakord me nenin 2?

Faleminderit! 1 Abstemin

Miratohet.

Faleminderit kolegë! Ta gëzojmë linjën e re!

Ju, uroj ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA